

Rahime Murtezani, MA¹
Ramadan Murtezani²

UDC:
323.1:342.72./73

**AVANCIMI I TË DREJTAVE TË PAKICAVE NË VENDET E
RAJONIT, RASTE KOMPARATIVE SHQIPËRI-KROACI**

**УНАПРЕДУВАЊЕ НА ПРАВАТА НА МАЛЦИНСТВОТА ВО
РЕГИОНАЛНИТЕ ЗЕМЈИ, КОМПАРАТИВНА СТУДИЈА
МЕЃУ АЛБАНИЈА И ХРВАТСКА**

**ADVANCING MINORITY RIGHTS IN REGIONAL COUNTRIES,
COMPARATIVE CASES BETWEEN ALBANIA AND CROATIA**

Abstract

The paper in question: “Advancing Minority Rights in Regional Countries, comparative cases between Albania and Croatia”. It is intended to address a topic that is closely related to one of the components of contemporary societies and states, which will, among other things, address the practices of the countries of the region. The paper in the beginning will also deal with international acts that address social diversity and protect their fundamental rights, which are protected by high legal norms and which must, of course, be incorporated into the positive domestic legal systems of states that seek to build a democratic system.

In addition to this, this scientific paper will take the comparative approach of states such as Albania and Croatia to isolate cases where citizens’ rights are respected, which does not represent the majority of

¹ Magister of Public Administration, SEE University, Tetovo, e-mail:rahime.murtezani1992@gmail.com

² Member of the Scientific Teaching Council at the Faculty of Contemporary Social Sciences, SEEU, Tetovo, e-mail: rm26432@seeu.edu.mk

the people's ethnicity in that country. It is about two countries that one of them is part of the EU and the other one is working towards EU integration; it is worth pointing out that they are two states that differ in one another in many aspects.

The purpose of this study based on the comparison made between the two above mentioned countries is to provide a descriptive overview of similarities and differences regarding the rights of ethnic groups that are not a dominant part of the majority, namely the determination of what characterizes one state from the other on minority rights, which operate within the territory of a state, as part of a society that does not constitute the majority.

Key words: *Minority, minorities, non-majority ethnical groups, ethnic rights, international acts.*

1. Hyrje

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta, të cilat i përkasin çdo njeriu që nga lindja. Ato janë universale, të pandashme, të domosdoshme dhe të padhunueshme, d.m.th.: Universale, e ky parim është parashikuar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit: “*Të gjithë njerëzit janë të lindur të lirë, me dinjitet dhe të drejta të barabarta*”. Të pandashme – i referohet faktit se të gjitha të drejtat kanë rëndësi; ato nuk duhet të ndahen. Parimi i ndërvarësisë, nënvizon sidomos faktin se të drejtat janë të ndërlidhura me njëra - tjetrën dhe mosrealizimi i një të drejte mund të sjellë mohimin ose mosrealizimin e një të drejte tjetër. Të patjetërsueshme dhe të padhunueshme – i referohet faktit që të drejtat e njeriut nuk mund t’i hiqen apo t’i mohohen askujt, qoftë edhe me pëlqimin dhe miratimin e tij, dhe asnjëri nuk mund të heqë dorë nga këto të drejta. (Imholz & Toska, f. 17) Minoritet/pakicë përkufizohet si një grup njerëzish që ndryshojnë në njëfarë forme nga shumica e popullsisë. (Your Dictionary) Jules Deschenes e përkufizonte një minoritet si: “*Një grup i qytetarëve të një shteti, që përbëjnë një pakicë numerike dhe që kanë një pozicion jodominant në atë vend, të pajisur me karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore që ndryshojnë nga ato të shumicës së popullsisë, zotërojnë një ndjenjë solidariteti me njëri-tjetrin, dhe janë të motivuar, në mënyrë të nënkuptuar, me një vullnet kolektiv për të mbijetuar, qëllimi i të cilës (pakicës) është për të arritur barazinë edhe faktikisht edhe ligjërish me shumicën*” (Ago, 2016, p. 16) Pakicat kombëtare (national minorities) – Sintagmë

e rëndësishme për shkencën politike, sociologjinë dhe të drejtën ndërkombëtare, që shënon grupet jo mbizotëruese të popullsisë, të cilat kanë dhe duan të ruajnë traditat e karakteristikat etnike, fetare ose gjuhësore, të cilat i dallojnë nga popullsia tjetër. Louis Wirthi thotë se pakicat janë grupe njerëzish, të cilët për shkak të cilësive fizike ose kulturore të tyre janë objekt i diskriminimit kolektiv. Bashkësi që janë të lidhura me një shtet tjetër, zakonisht me një shtet fqinj. Kështu p.sh.: në Kroaci jeton një pakicë italiane etj. Sipas Giddensit, anëtarët e pakicave etnike shpesh janë në kushte më të këqija si pasojë e diskriminimit nga të tjerët, e shikojnë veten si “njerëz të ndarë” nga shumica për arsye se janë ndarë nga shoqëria e gjerë si fizikisht ashtu edhe nga ana sociale. (Pajaziti, 2009, f. 467)

2. Mbrojtja e të Drejtave të Pakicave Kombëtare në Dokumentet Ndërkombëtare

Kombet e Bashkuara kah fundi i vitit 1960 filluan ta marrin seriozisht çështjen e minoriteteve, pra pas aprovimit të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, neni 27 i së cilës përmban dispozitën e parë të përgjithësuar ndërkombëtare mbi të drejtat e minoriteteve, ndonëse me efekt të dobët. (Alfredsson & Eide, f. 640)

Vetëm në 15 vitet e fundit komuniteti ndërkombëtar ka filluar të kushtojë më shumë vëmendje dhe të zbatojë masa konkrete për mbrojtjen e grupeve etnike, fetare dhe gjuhësore. Si masa më të rëndësishme në nivel të Kombeve të Bashkuara është adoptimi i Deklaratës për të Drejtat e Personave që u përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Religjioze ose Gjuhësore dhe krijimi i Grupit Punues për Pakicat Kombëtare. Detyrat kryesore të *Grupit Punues për Minoritetet Kombëtare* janë mbikëqyrja e zbatimit të Deklaratës, planifikimi i zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohen pakicat dhe rekomandimi i masave të mëtejshme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Dokumenti më crucial për të drejtat e etnive kombëtare është Deklarata e lartpërmendur. Përveç kësaj Deklarate, dokumente të tjera të OKB-së në të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (duke filluar nga parimi i barazisë për të gjithë njerëzit), ku theksohet nevoja e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare, si: Karta e Kombeve të Bashkuara (1945), Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (1948), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966),

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), dhe disa dokumente të tjera. Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave është një dokument, shqetësimi kryesor i të cilit është mbrojtja e gjuhëve të pakicave dhe dialekteve të Evropës dhe ruajtjen e kulturave, zakoneve dhe traditave të popujve ose grupeve që përdorin këto gjuhë. (The Position of National Minorities in the Republic of Croatia – Legislation and Practice, 2005) Akti ndërkombëtar që shpreh detyrimet e shteteve anëtare për respektimin e të drejtave themelore të njeriut është *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (1950) ose KEDNJ, e miratuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura nga KEDNJ janë si: e drejta e jetës, e drejta për respektim të integritetit fizik, e cila nuk lejon veprime të tilla si tortura, trajtimet çnjerëzore ose degraduese, si skllavëria, robëria, ose puna e dhunë apo e detyruar, e drejta e lirisë dhe sigurisë personale, e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, e drejta për të krijuar familje, dhe barazia mes burrit dhe gruas. Në vazhdim, KEDNJ mbron disa të drejta vetjake të lidhura me personin: e drejta e lirisë së mendimit, e besimit dhe e fesë, e drejta e lirisë së shprehjes, e drejta e lirisë për t'u mbledhur dhe për të krijuar organizata, përfshirë dhe sindikata; e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike, e drejta për respektimin e pronës dhe pasurisë, përfshirë dhe shpronësimin e drejtë në rast të një shpronësimi të lejueshëm, vetëm për qëllime publike, e drejta për t'u arsimuar në gjuhën amtare, e drejta e personit për të mos u dëbuar nga shteti shtetësinë e të cilit ka, si edhe e drejta për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e një shteti, ku ai gjendet në mënyrë të ligjshme. (Imholz & Toska, f. 35) Në kuadër të *Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike* (1966), shtetet anëtare janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha hapat për realizimin e plotë të së drejtave. Të drejtat e parashikuara në Konventë janë: e drejta për jetën, ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor, e drejta për liri dhe siguri, liria e lëvizjes dhe zgjedhja e vendbanimit, barazia para ligjit, e drejta për privatësi dhe jetë familjare, shtëpi dhe korrespondencë, liria e shprehjes, e drejta e organizimit dhe e drejta e anëtarësimit. (Imholz & Toska, f. 39) Të drejtat e mbrojtura nga Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike përfshijnë të drejtat e njeriut duke filluar nga e drejta për jetë (neni 6) e deri te pjesëmarrja në jetën publike (neni 25), pastaj nga e drejta për vetëvendosje e popujve (neni 1) e deri tek të drejtat e anëtarëve të pakicave (neni 27). Ndalimi i diskriminimit (neni 26) është për nga natyra gjithëpërfshirës dhe

përfshinë edhe sferat sociale, ekonomike dhe kulturore. (Hanski & Scheinin, 2003, f. 12) *Karta Themelore e të Drejtave të BE-së* (2000), është një dokument gjithëpërfshirës dhe modern i të drejtave të individit, përfshirë, zhvillimet shkencore dhe teknologjike si dhe ndryshimet e fundit sociale. Karta i parashikon të drejtat në gjashtë “tituj”, përkatësisht: dinjteti, liria, barazia, solidariteti, të drejtat e qytetarit dhe drejtësia. (Imholz & Toska, fv. 42-43) Sipas *Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare* (1995), mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave e lirive të personave që iu përkasin këtyre pakicave janë pjesë përbërëse e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe, si të tilla, përfshihen në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar (neni 1).

Personat që u përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë që burojnë prej parimeve të parashikuara në këtë Konventë kuadër në mënyrë individuale si dhe në bashkësi me të tjerë (nenit 3). (Gruda, 2007, f. 478)

3. Të drejtat e minoriteteve në Shqipëri

Shqipëria ka qenë vazhdimisht e angazhuar për t’iu bashkuar familjes së madhe të vendeve europiane dhe të gjitha vendeve të tjera të komunitetit ndërkombëtar, që respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare e kanë vendosur në themel të sistemeve të tyre shtetërore. (Shqipërisë R. e., 2001, p. 17) Përkushtimi i Shqipërisë ndaj mbrojtjes së minoriteteve filloi pas Luftës së Parë Botërore, me hyrjen e saj në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920. (Demjaha & Peci, 2014, f. 8) Respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare Qeveria shqiptare e konsideron si një detyrim që buron nga orientimi themelor i Republikës së Shqipërisë për të mbrojtur e respektuar të drejtat dhe liritë themelore të individit. Nga pikëpamja etnike, 98% e popullsisë është shqiptare dhe vetëm 2% përbëhet nga pakica kombëtare greke, maqedonase dhe malazeze. Në Shqipëri tradita historike ka ecur në rrugën e njohjes si pakica kombëtare të atyre minoriteteve që kanë një komb amë, me të cilin kanë karakteristika të përbashkëta, si: konstitucionin shpirtëror, gjuhën, kulturën, zakonet e traditat, besimin fetar etj. Si pakica të tilla janë konsideruar pakica greke, maqedonase dhe malazeze. Megjithatë, duhet theksuar se pjesëtarët e pakicës greke kanë ndarë fatin e shumicës së popullsisë dhe kanë vuajtur të njëjtat kufizime të imponuara nga regjimi, por pjesëtarët e minoritetit grek nuk kanë qenë objekt i një diskriminimi të posaçëm.

Ndryshimet demokratike në Shqipëri gjatë dekadës së fundit kanë sjellë ndryshime thelbësore edhe në pozitën e minoritetit kombëtar grek. Ajo është përmirësuar dhe sot ky etnitet gëzon të gjitha të drejtat, në përputhje me standardet më liberale evropiane dhe vlerat që rregullojnë jetën e një shoqërie të hapur demokratike dhe pluraliste. (Shqipërisë R. e., 2001, fv. 4-8-9-12) Aktualisht, Shqipëria si minoritete kombëtare i njeh grekët, maqedonasit, malazezët dhe serbët, ndërkaq, vllahët/arumunët dhe romët njihen vetëm si minoritete linguistike/kulturore. Si minoritetet kombëtare, ashtu edhe ato linguistike, janë të njohura sipas traktatit multilateral të Këshillit të Evropës – Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMK) – që Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1999. (Demjaha & Peci, 2014, f. 8). Në këtë kuptim, politika e shtetit shqiptar ngrihet mbi dy boshtet themelore që përcaktojnë instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave kombëtare:

- garantimin ligjor dhe zbatimin në praktikë të së drejtës për një trajtim jodiskriminues të personave që u përkasin pakicave kombëtare në gëzimin e plotë e të gjitha të drejtave njerëzore, si dhe të drejtave civile e lirive politike që Kushtetuta dhe legjislacioni u njohin të gjithë shtetasve shqiptarë;

- garantimin ligjor dhe marrjen e masave konkrete për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, duke ushtruar lirisht e në mënyrë të papënguar ato elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre si pakicë, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj. (Shqipërisë R. e., 2001, f. 8)

Shqipëria është anëtare e OKB-se dhe anëtare e Këshillit të Evropës që nga viti 1955 dhe ka ratifikuar pothuaj të gjitha konventat kryesore të kësaj organizate lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, disa nga ato janë:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948;
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966;
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore 1976;

- Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, 1951, (ratifikuar me Ligjin 8137, 1996) dhe Protokollat 1, 2, 4, 6, 7, 11 të kësaj Konvente,

- Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare 1995 (ratifikuar me Ligjin 8496, 1999);

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i konsideron pakicat kombëtare pjesë të pandarë të shoqërisë shqiptare. Ajo u garanton atyre barazi të plotë para ligjit në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të tyre (neni 18, paragrafi 1), ndalon diskriminimin e padrejtë për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindja politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore (neni 18, paragrafi 2), si dhe u njuh të drejtën “të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore”, (neni 20, paragrafi i dytë), të drejtën “për t’i ruajtur e zhvilluar ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata dhe shoqata për mbrojtjen e interesave dhe identitetit të tyre”. (Shqipërisë R. e., 2001, fv. 17-18-21). Shqipëria ka bërë, po ashtu, përmirësime në përfaqësimin politik të minoriteteve, duke siguruar, kësaj, që këto të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate, të paktën në nivelin lokal, nëse jo edhe në atë kombëtar. (Demjaha & Peci, 2014, f. 12).

Mbrojtje nga aktet e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të pakicave kombëtare ofron edhe neni 14 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e ratifikuar nga Shqipëria. Gjatë vitit 2000, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme është krijuar *Zyra e Pakicave Kombëtare*, e cila, ndër detyrat e saj themelore, duke respektuar ligjet e brendshme, ka ndjekjen e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare të vendit në fushën e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare. Po ashtu, është krijuar dhe funksionon një *Sektor për pakicat kombëtare* (1998), në Drejtorinë e Prefekturave pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal, qëllimi i së cilës është trajtimi i problemeve që lidhen me pjesëmarrjen efektive të pakicave në procesin e vendim-marrjes në nivelin e qeverisjes vendore dhe administratës publike. (Shqipërisë R. e., 2001, fv. 23-24) Fakti që minoriteti etnik grek merr pjesë lirshëm në politikën shqiptare tregon që grupi vështirë se mund të përjetojë çfarëdo disavantazhesh për shkak të ndonjë diskriminimi të paramenduar grupor. (Demjaha & Peci, 2014, f. 11).

Të drejta të barabarta për të gjithë ofron edhe legjislacioni në fushën e arsimit. Neni 3 i Ligjit 7952, 1995, “*Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar*”, “garanton të drejta të barabarta për të gjithë shtetasit për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimimit që përcaktohen nga ky ligj, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik”. Për trajtimin e problemit të shkollimit të fëmijëve që i takojnë pjesëtarëve të shoqërisë që nuk përbëjnë shumicën kujdeset njëri nga inspektorët nga

Drejtoria e Arsimit 8-Vjeçar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. (Shqipërisë R. e., 2001, fv. 23-24) Sa i përket edukimit, mësimdhënie në maqedonisht ka pasur brenda zonës së minoritetit që nga viti 1945, dhe atë në arsimin fillor deri në klasën e pestë, dhe për të tekstet shkollore janë botuar nga shteti. (Demjaha & Peci, 2014, p. 12). Pjesëtarëve të pakicave kombëtare në Shqipëri u garantohet mbrojtje ligjore (trajtim të barabartë) në fushën e marrëdhënieve me administratën publike, ku sipas nenit 11 të Kodit për Procedurë Administrative, në paragrafin 1, është paraparë që “Në marrëdhëniet me personat privatë administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë, në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohej apo diskriminohet”. Kodi i Punës neni 9, që mbulon marrëdhëniet në fushën e punës, si në atë publike, ashtu edhe atë private, ndalon çdo lloj diskriminimi në punësim apo në jetën profesionale. (Shqipërisë R. e., 2001, fv. 22-23).

Angazhimin e qeverisë shqiptare në mbrojtjen e të drejtave ligjore të etnisë së dytë e vërejmë në tentimin e realizimit të hartimit të strategjisë kombëtare “*Për përmirësimin e kushteve të jetesës së etnitit rom*”, ndërsa, fushat të cilat i parasheh kjo strategji janë:

1. *Arsimi* - përgatitja e një programi për të inkurajuar fëmijët romë që të ndjekin shkollën ku të përfshihet dhe puna e asistentëve sociale me prindërit romë.

2. *Arti dhe Kultura* - organizimi i veprimtarive kulturore me qëllim afirmimin e identitetit të tyre si dhe promovimin e aspekteve pozitive të kulturës rome.

3. *Mediat dhe Pjesëmarrja në jetën civile*

4. *Punësimi, Strehimi dhe Çështjet Sociale*

5. *Rendi publik* - marrja e masave disiplinore kundër atyre punonjësve të policisë të cilët në kryerjen e detyrës diskriminojnë ose keqtrajtojnë persona për faktin se janë romë.

6. *Administrata qendrore dhe lokale* - mbështetja e të rinjve romë të cilët mbarojnë shkollën për t’u futur në tregun e punës.

7. *Shëndetësia* - asistencë në medikamente mjekësore për familjet rome

8. *Drejtësia* -respektimi i të drejtave të njeriut dhe në veçanti të së drejtave të minoriteteve konform Konventave Ndërkombëtare në të cilat vendi ynë aderon.

9. *Ekonomi* - uljen e nivelit të papunësisë të romëve nëpërmjet krijimit të politikave lehtësuese fiskale për ato kompani të cilat punësojnë anëtar të komunitetit rom. (Shqipërisë Q. e., 2003)

Duhet thënë se në familjet e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, qofshin këto greke, maqedonase apo malazeze, por edhe në familjet e pakicave linguistike të romëve dhe arumuneve, gjuha amtare është transmetuar nga brezi në brez.

Ndonëse sipas Kushtetutës (neni 14), “*gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe*”, pakicat kombëtare, sipas nenit 20 të Kushtetutës, kanë të drejtë të ruajnë, të zhvillojnë e “*të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare*”.

E drejta për të përdorur gjuhën amtare privatisht dhe në publik është e garantuar edhe në praktikë. Individët nga pakicat kombëtare e përdorin gjuhën e tyre lirisht në jetën e përditshme, me njëri-tjetrin, në mbledhjet publike, në shoqatat e tyre, në fushatat elektorale, në shtypin e tyre, në botimet e tyre me karakter kulturor, letrar, historik apo shkencor, në media, si dhe në ceremonitë fetare. (Shqipërisë R. e., 2001, f. 25).

Sidoqoftë, duhet të vërehet që, në përgjithësi, në Shqipëri mbizotëron një klimë e respektimit dhe tolerancës midis minoriteteve kombëtare dhe popullatës shumicë. (Demjaha & Peci, 2014, f. 12)

4. Të drejtat e minoriteteve në Kroaci

Republika e Kroacisë ka nënshkruar një numër të kontratave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, bilaterale (dypalëshe), multilaterale që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, sikurse: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale, Karta për gjuhët rajonale dhe minoritetit, Konventa Kuadër për Mbrojtjen Pakicave Kombëtare, Traktatin për Mbrojtjen e Pakicave Italiane në Republikën e Kroacisë dhe Pakicat Kroate në Republikën e Italisë, etj. (Kuntic, 2003, f. 34) *Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës* është dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar për Kroacinë që mbron të drejtat e pakicave kombëtare, pasi nënshkruerit e vendeve janë të dakorduar të zbatojnë masat konkrete të parashikuara në këtë Konventë. (The Position of National Minorities in the Republic of Croatia –Legislation and Practice, 2005) Mbrojtja e të drejtave të anëtarëve të pakicave kombëtare në Republikën e Kroacisë konsiderohet si ndër më të mirat në Evropë. (Kuntic, 2003, f. 34) Kushtetuta e Republikës së Kroacisë deklaroi se Republika e Kroacisë është themeluar si shtet kombëtar i popullit kroat dhe shteti i anëtarëve të

pakicave kombëtare, si: *serbët, çekët, sllovakët, italianët, hungarezët, hebrenjtë, gjermanët, austriakët, ukrainasit, rusët, boshnjakët, sllovenët, malazezët, maqedonasit, rusët, bullgarët, polakët, romët, rumunët, turqit, vlllehët, shqiptarët* dhe të tjerët që janë qytetarë të saj dhe të cilëve u garantohet barazia me qytetarët e Kroacisë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre kombëtare në përputhje me normat demokratike e Kombeve të Bashkuara dhe vendeve të botës së lirë. (Constitution of the Republic of Croatia, 2010) Sipas Kushtetutës së saj, Republika e Kroacisë siguron mbrojtjen e etnitetit të dytë nga çfarëdo lloj diskriminimi. Ata kanë të drejtën e identitetit dhe pjesëmarrjen në çështjet publike. Anëtarët e etnitetit të dytë ushtrojnë të drejtat e tyre njëjtë sikurse të gjithë qytetarët apo shtetasit në Republikën e Kroacisë përmes institucioneve të rregullta në bazë të dispozitave kushtetuese, Ligjit Kushtetues, Ligjit për zgjedhjen e përfaqësuesëve në Parlamentin Kroat, Ligjit për zgjedhjen e anëtarëve të trupave përfaqësues të njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe administratës dhe Ligjit për partitë politike. Ligji Kushtetues për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe të Drejtat e Komuniteteve Etnike dhe Kombëtare apo Minoriteteve dhe Republika e Kroacisë mbron barazinë e pakicave kombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë së bashku me Ligjin Kushtetues për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe të Drejtat e Komuniteteve Etnike dhe Kombëtare ose Minoriteteve, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoriteteve siguron të drejtat kundër çfarëdo lloji diskriminimi, të drejtën për ekzistencë, identitet dhe pjesëmarrje në çështjet publike. (Kuntic, 2003, fv. 34-36) Edhe përkundrejt pranisë së minoriteteve të tjera në vend, marrëdhëniet ndëretnike në Kroaci ishin dhe vazhdojnë të jenë kryesisht të përcaktuara nga marrëdhëniet midis kroatëve dhe serbëve etnikë. Rregullimi i çështjes së serbëve është rregulluar sipas Marrëveshjes së Erdut, flitet për një dokument të rëndësishëm që siguron një rregullim afatgjatë të disa çështjeve të rëndësishme për pjesëtarët e pakicës kombëtare serbe. Nga kjo marrëveshje përfaqësuesve të komunitetit serb iu garantua e drejta e përfaqësimit politik në nivel lokal dhe shtetëror (në Saborin kroat) dhe një organ këshillues në formën Këshillit të Pakicës Kombëtare Serbe. (The Position of National Minorities in the Republic of Croatia – Legislation and Practice, 2005) Duhet përmendur që marrëdhëniet midis serbëve dhe kroatëve e kanë një histori të hidhur që shkon prapa në Luftën e Dytë Botërore. (Demjaha & Peci, 2014) Minoritetet mund të mbrohen nga mekanizmat si

autonomia territoriale, personale dhe kulturore. Autonomia territoriale mund t'i jepet etnitetit të dytë nëse është e përqendruar në një territor ku numri i anëtarëve të tij është më i madh se numri i shtetasve të tjerë. Nëse etnitetet e dyta janë të shpërndara në një zonë më të gjerë, mbrojtja e tyre mund të organizohet përmes autonomisë personale ose pjesëmarrjes proporcionale në organet autoritative. Forma e tretë është autonomia kulturore e cila mund të jetë zgjidhja e vetme për mbrojtjen e grupit etnik që nuk përbën shumicën, nëse ato nuk janë të shumtë dhe janë të shpërndara në një zonë më të gjerë. (Kuntic, 2003, f. 34) Sipas Nenit 14 të Kushtetutës së Kroacisë: “Çdo person dhe qytetar i Republikës së Kroacisë ka të gjitha liritë dhe të drejtat, pavarësisht racës, lëkurës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, përkatësisë politikës, prejardhjes kombëtare ose sociale, pronës, lindjes, arsimimit, statusit social apo karakteristikave të tjera. Të gjithë personat duhet të jenë të barabartë përpara ligjit”. Ndërsa sipas nenit 15 të Kushtetutës, sigurohen të drejta të barabarta për pjesëtarët e të gjitha pakicave kombëtare në Republikën e Kroacisë. (Constitution of the Republic of Croatia, 2010) Gjithashtu, garanton përdorimin e lirë të gjuhës së tyre, të drejtën për simbolet e tyre, kulturën, qasjen në media, botimin e librave në gjuhën dhe shkrimin e tyre. Duke u bazuar në këto të drejta qytetarëve u garantohej e drejta e lirë në asociacione që u mundëson atyre të mbrojnë mirëqenien e vet apo mbrojtje sociale, ekonomike, politike, kombëtare, kulturore ose besime dhe qëllime tjera. (Kuntic, 2003, f. 36) Po ashtu, **Ligji Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve** mbron të drejtat e etnisë që nuk përbëjnë shumicën, si:

- përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, (përdorimin publik, privatisht dhe zyrtar);
- arsim në gjuhën dhe shkrimin e pakicave; përdorimin e shenjave dhe simboleve;
- ruajtjen e autonomisë kulturore, zhvillimin dhe shprehjen e kulturës së vet, ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive dhe traditave kulturore;
- të drejtën për të shprehur fenë dhe për të krijuar bashkësi religjioze së bashku me anëtarët e tjerë të atij religjioni; qasja në media, marrja dhe përcjellja e informacionit në gjuhën dhe shkrimin e tyre;
- vetorganizim dhe shoqata për qëllimin e ushtrimit të interesave të përbashkëta;
- përfaqësim në organet përfaqësuese të nivelit shtetëror dhe lokal, si dhe në organet administrative dhe gjyqësore;

- pjesëmarrje në jetën publike dhe në menaxhimin e çështjeve lokale përmes këshillave dhe përmes përfaqësuesve të pakicave kombëtare;

- mbrojtje nga çdo aktivitet që rrezikon ose mund rrezikojë ekzistencën e grupeve etnike që nuk përbëjnë shumicën dhe ushtrimin e të drejtave. (Tatalovic, 2003, f. 20)

Minoritetet përbëjnë 7.5 % të kroatëve por vetëm 4.9 % e të punësuarve nga organet gjyqësore janë nga minoritetet (serbët etnik përbëjnë vetëm 2.4 për qind të stafit gjyqësor). Në vitin 2003, nga 66 gjyqtarë të punësuar nga organet gjyqësore, 65 janë të etnitetit kroat dhe të gjithë avokatët shtetërorë janë të etnisë kroate. Serbët përbëjnë vetëm 2.6 për qind të nëpunësve dhe punonjësve në gjykata dhe prokurori të shtetit. (Mikic, p. 3) Në fushën politike, etnisë së dytë i është dhënë e drejta për pjesëmarrje proporcionale në parlamentin kroat dhe qeverinë kroate, nëse pjesa e tyre në popullsinë e përgjithshme është së paku 8%. (Kuntic, 2003, f. 36). Një organ tjetër i rëndësishëm që angazhohet në mbrojtjen e të drejtave të etnitetit të dytë është Këshilli për Pakicat Kombëtare, i cili mundëson ngritjen e mënyrës së shqyrtimit dhe propozimit për rregullimin dhe adresimin e çështjeve që lidhen me ushtrimin dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive të komuniteteve që nuk përbëjnë shumicën. Në këtë drejtim, Këshilli bashkëpunon me organet kompetente të qeverisë dhe institucioneve tjera që angazhohen me aktivitetet që i referohen ushtrimit të të drejtave dhe lirive. Ky këshill shpërndan fondet e buxhetit të shtetit për nevojat e pjesës së shoqërisë që nuk përbën shumicën (neni 34). (Constitutional Law on the Rights of National Minorities, 2002) **Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe Shkrimit të Pakicave Kombëtare** (NN 51/00) parashikon përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit të pakicave kombëtare në organet përfaqësuese, ekzekutive, administrative dhe gjyqësore në nivel të bashki-ve/komunave dhe qarqeve. Këto organe janë përgjegjëse për përdorim të barabartë të gjuhës së etnisë së dytë në të gjitha aktivitetet dhe dokumentet zyrtare si dhe për punësimin e numrit të nevojshëm të punonjësve që të jenë të aftë për të kryer procedurat në gjuhën dhe shkrimin e tyre (neni 21). (The Position of National Minorities in the Republic of Croatia – Legislation and Practice, 2005). Sipas nenit 37 të Kushtetutës, Qeveria e Kroacisë koordinon punën e organeve qeveritare në aplikimin e Ligjit kushtetues dhe ligjeve të veçanta që rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare. Ndërkaq, sipas Këshillit për Pakicat Kombëtare mund të kërkojë nga qeveria kroate që të

shqyrtojë zbatimin e Ligjit kushtetues dhe të ligjeve të veçanta që rregullojnë të drejtat dhe liritë e etnitetit të dytë nga organet qeveritare dhe të ndërmarrin veprime për të siguruar ligjshmërinë e procedurës (neni 38). (Constitutional Law on the Rights of National Minorities, 2002) Në **Aktin për të Drejtën e Arsimit të Pakicave Kombëtare**, theksohet se pakicave kombëtare u garantohet e drejta për arsim në gjuhën e pakicave në të gjitha nivelet arsimore. Është paraparë që shumica e anëtarëve të organeve administrative të institucioneve arsimore duhet të jenë anëtarë të pakicave kombëtare (neni 12) dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit është e obliguar të sigurojë numrin e nevojshëm të asistentëve dhe këshilltarëve që janë anëtarë të pakicave kombëtare ose që i njohin gjuhët e tyre (neni 13). Mjetet e nevojshme për funksionimin e këtyre shkollave ndahen nga Buxheti i Shtetit (Neni 16). (The Position of National Minorities in the Republic of Croatia – Legislation and Practice, 2005)

5. CONCLUSION

In general terms, we can conclude that, in the international aspect, there is no lack of legislation or legal frameworks guaranteeing basic rights to (minorities) ethnic minorities or in the practice of Albania and Croatia minority enjoy the rights guaranteed by law.

This issue is foreseen in the legal aspect of European law, but not only; there are also acts that go beyond European borders.

In the scientific approach of the researchers and the political analysis, things are about an experience that needs a greater dedication to the functioning and the good practices of these two countries, which in the first case we have Croatia, an EU member country that has managed to create genuine standards, includes this component of a better experience of legal guarantee of minority rights and implementation in practice.

On the other hand, Albania, in spite of the tendencies for the continuous political and economic consequences, has much to do in promoting and enforcing laws referring to minority rights in the country.

This implies that a state does not only need the political readiness or will to create and adopt international laws referring to minority rights, but these legal consequences must have or precede an investment from the state budget to take the lead right. Therefore, these two

components of the political and economic factor, if they are stronger, the state will have to serve even better practices of creating and enforcing legal acts in the country. This will then also reflect a better life, between a society and people who make up a state of a different culture, valued and well-treated by the state or the institutions that make up it.

Recensentë:

Doc. dr. Memet Memeti

Doc. dr. Besa Kadriu

7. Bibliografia

Ago, O. (2016). Pakicat kombëtare dhe roli i tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor . p. 16.

Alfredsson, G., & Eide, A. *Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut*. London: Martinus Nijhoff Publisher.

Constitution of the Republic of Croatia. (2010, July 6). <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/hr/hr060en.pdf> , pp. Neni 14-15.

Constitutional Law on the Rights of National Minorities. (2002, December 13).

Demjaha, A., & Peci, L. (2014, Dhjetor). Marrëdhëniet ndëretnike në ballkanin perëndimor: implikimet për kosovën. pp. 8-9-11-12-17.

Gruda, Z. (2007). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut* . Uniiiversiteti Fama.

Hanski, R., & Scheinin, M. (2003). *Rastet kryesore të komitetit për të drejtat e njeriut*. Finlandë: Instituti për të drejtat e njeriut-Turku/Abo.

Imholz, K., & Toska, E. (n.d.). Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut: Manual për Administratën Publike. <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2017/05/manual-t%C3%AB-drejtat-e-njeriut.pdf>, pp. 17-18.

Kutic, D. (2003, JANUARY - JUNE). Minority Rights in Croatia. pp. 33-34-36.

Mikic, L. (n.d.). Croatia: Challenges for Sustainable Return of Ethnic Serb Refugees. *Minority Rights Group International* , pp. 1-2-3.

Pajaziti, A. (2009). *Fjalor i Sociologjisë*. Shkup: LOGOS-A.

Shqipërisë, Q. e. (2003). Komentet e qeverisë shqiptare mbi “opinionin” e komitetit këshillues të “konventës kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare”.

Shqipërisë, R. e. (2001). *Raport mbi Pakicat Kombëtare në Shqipëri*.

Tatalovic, S. (2003). *Minorities in Croatia*. Minority Rights Group International, Department for International Development and the European Commission. MRG.

The Position of National Minorities in the Republic of Croatia – Legislation and Practice. (2005, April). *An Overview of the Croatian Legislation Providing for the Rights of National Minorities* .

Your Dictionary. (n.d.). April 26, 2019, from <https://www.yourdictionary.com/minority>